

DUHET SHMANGUR NJË VARËSI E TEPRUAR NGA PASURITË E PALUAJTSHME

Ritja e lartë e kredisë ka ndjekur ecurinë e sektorëve më aktivë dhe me kontribut të lartë në rritjen ekonomike. Flutura Veipi, drejtore e përgjithshme e Union Bank, thotë për "Monitor" se megjithatë, rritja e financimit të pasurive të paluajtshme përbën rrezik të përqendrimit dhe mund të krijojë një varësi të tepruar nga një sektor i vetëm. Për këtë arsye, sipas saj, Union Bank po punon për diversifikimin e portofolit të huave duke financuar edhe degë të tjera të ekonomisë, pa u përqendruar në një treg të vetëm. Znj. Veipi thotë se në vitet e fundit, Union Bank ka marrë një rol më aktiv duke kredituar bujqësinë, dhe sektorë të lidhur me të, investimin në fushën e eficiencës së energjisë dhe shumë shërbime të lidhura me sektorin e turizmit.

Si e vlerësoni ecurinë e aktivitetit të Union Bank gjatë vitit të kaluar dhe cilat ishin, në këndvështrimin tuaj, zhvillimet më të rëndësishme për sektorin bankar në përgjithësi?

Viti 2024 ka qenë me rritje të qëndrueshme për Union Bank duke konsoliduar pozicionin tonë në treg dhe duke zgjeruar shërbimet ndaj klientëve. Banka ka forcuar pjesën e saj të tregut duke u renditur si banka e pestë në treg për rritjen e aktiveve, duke performuar mbi mesataren dhe duke ruajtur një ritëm pozitiv të rritjes së depozitave prej 4,7% në vitin 2024. Me një qasje të orientuar drejt zhvillimit të biznesit vendas, Union Bank ofron financime fleksibël që mbështesin projekte strategjike dhe nxisin investimet. Bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare, si BERZH, ka ndihmuar në zgjerimin e aksesit në financa për bizneset dhe në forcimin e rolit të bankës në zhvillimin ekonomik të vendit, nëpërmjet disa linjave për kreditim specifik si p.sh.: Drejt dixhitalizimit (Go Digital); Të rinjtë në Biznes (Youth in business) dhe Linja për Suportin e Agrobiznesit dhe Turizmit në Shqipëri (AATSF).



FLUTURA VEIPI

Drejtore e Përgjithshme
Ekzekutive e Union Bank

Në aspektin financiar, Union Bank ka ruajtur qëndrueshmërinë e saj dhe këtë e tregojnë RoA prej 1.9% dhe RoE prej 20.9% (tregues i cili na rendit të pestët në treg), duke konfirmuar një performancë të shëndoshë edhe për vitin 2024. Kartat e kreditit kanë shënuar gjithashtu një rritje nga 6.8% në 2023 në 7.97% në fund të vitit 2024. Por mbetet ende për t'u bërë në investimet në platformën dixhitale, e cila është në fokus të Union Bank për vitin 2025 dhe më tej.

Në shërbimin ndaj klientit kemi investuar në përvojën e personalizuar duke investuar si në rritjen e cilësisë së punonjësve tanë për ofrimin e shërbimit dhe këshillimit, ashtu edhe në përmirësimin e ofertës në kanalet dixhitale, për të sjellë shërbimet e bankës pranë klientëve 24 orë në ditë. Monitorojmë NPS për të kuptuar nevojat e klientëve tanë dhe për të sjellë përmirësime të vazhdueshme.

Gjatë vitit 2024, u regjistrua një rritje e shpejtë e kreditimit, veçanërisht për financimin e

pasurive të paluajtshme dhe në segmentin e biznesit të madh, ndërsa Banka e Shqipërisë vendosi të aplikojë për herë të parë shtesën kundërciklike të kapitalit.

Besoni se ka vend për shqetësim në lidhje me rritjen e ekspozimit të sektorit bankar në sektorin e pasurive të paluajtshme dhe me shtimin e ekspozimeve të mëdha në segmentin e korporatave?

Rritja e kreditimit në vitin 2024 në Union Bank ishte 9.3%. Kjo rritje është e diversifikuar në kredi për biznes dhe retail, me një ritëm të ngjashëm rritje në të dy segmentet. Por e shpërndarë në një masë të gjerë klientësh, ku fokusi i bankës është shtrirja dhe ofrimi i shërbimeve për një bazë sa më të madhe klientësh, më tepër sesa rritja e portofolit kreditor në volum. Rritja, nga ana sektoriale, është në korrelacion me sektorët më aktivë dhe me kontribut të lartë në rritjen ekonomike si p.sh.: sektori i pasurive të paluajtshme, hoteleria dhe shërbimet e lidhura, si dhe tregtia dhe sektori bujqësor. Mbi masën kundërciklike të aplikuar, citoj se Banka e Shqipërisë ka për detyrë të sigurojë stabilitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit financiar. Në rast se në analizat e saj konstaton një prirje që mund të mbartë rreziqe për të ardhmen, ajo ndërhyr me masat e saj të përshtatshme, siç mund të jetë edhe shtesa kundërciklike, duke synuar ruajtjen e një qasje më konservatore, në mënyrë që stabiliteti i sotëm të garantojë edhe atë të së nesërme. Bëhet fjalë thjesht për një masë parandaluese, që synon të shmangë akumulimin e rreziqeve në të ardhmen, pa ndikuar në ritmin e zhvillimit të ekonomisë dhe në kërkesën për kredi. Për ne bankat është e rëndësishme të respektojmë treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të sigurojmë rezerva të mjaftueshme mbi këtë prag.

Sektori i ndërtimit është një nga degët kryesore të ekonomisë që kontribuon ndjeshëm në rritjen e

← PBB-së. Union Bank, ashtu si edhe bankat e tjera, ka financuar këtë sektor, duke mbështetur individët nëpërmjet kredive hipotekore, si dhe duke financuar projekte madhore në infrastrukturë, energji dhe turizëm. Rritja e financimit të pasurive të paluajtshme përbën një rrezik të përqendrimit dhe mund të krijojë një varësi të tepruar nga një sektor i vetëm. Për këtë arsye, po punojmë për diversifikimin e portofolit të huave, duke financuar edhe degë të tjera të ekonomisë, pa u përqendruar në një treg të vetëm. Në vitet e fundit kemi marrë një rol më aktiv duke kredituar bujqësinë dhe sektorë të lidhur me të, investimin në fushën e eficientës së energjisë dhe shumë shërbime të lidhura me sektorin e turizmit.

Cilat mendoni se do të jenë çështjet dhe sfidat kryesore për sektorin bankar për vitin 2025?

Viti 2025 paraqitet si një periudhë me mundësi, por edhe me sfida që kërkojnë një qasje të kujdesshme dhe të balancuar. Duhet të jemi të përgatitur për të vepruar në një mjedis të ndryshueshëm politik dhe ekonomik, duke pasur parasysh se vendi ndodhet në prag zgjedhjesh elektorale. Viti 2024, siç edhe e përmenda më sipër, ishte mjaft pozitiv për Union Bank dhe për sektorin bankar në tërësi, dhe kjo krijon mundësi për të qenë më aktivë, por duke ndjekur një qasje më të kujdesshme në vendim-marrje gjatë kësaj periudhe. Një nga zhvillimet kryesore do të jetë zbatimi i projekteve që lidhen

me Open Banking dhe SEPA. Hapja e sektorit bankar ndaj palëve të treta dhe integrimi me sistemet europiane të pagesave është një hap i rëndësishëm për modernizimin e shërbimeve financiare dhe rritjen e konkurrencës. Kjo për ne do të kërkojë investime në infrastrukturë dhe teknologji, si dhe përshtatjen e rregulloreve për të garantuar sigurinë e të dhënave dhe mbrojtjen e klientëve nga rreziqet e reja kibernetike.

Dixhitalizimi dhe siguria kibernetike mbeten sfida të përditshme edhe për Union Bank. Me rritjen e përdorimit të shërbimeve online, klientët presin një banking më të avancuar, më të sigurt dhe më të personalizuar. Po vijojmë me investimet në upgrade të platformave tona ekzistuese dhe në platforma të reja dhe në sisteme të forta sigurie për të mbrojtur të dhënat e klientëve dhe për të minimizuar rreziqet e sulmeve kibernetike.

Një tjetër prioritet do të jetë rritja e kredithënies dhe diversifikimi i portofolit, për të mbështetur projektet më strategjike për zhvillimin e vendit, por duke sjellë dhe risi si kreditimi i të rinjve në biznes, linja të veçanta për investimet e SME-ve në dixhitalizim të proceseve të tyre, etj. ■

DIVERSIFIKIM

Rritja e financimit të pasurive të paluajtshme përbën një rrezik të përqendrimit dhe mund të krijojë një varësi të tepruar nga një sektor i vetëm. Për këtë arsye, po punojmë për diversifikimin e portofolit të huave, duke financuar edhe degë të tjera të ekonomisë, pa u përqendruar në një treg të vetëm. Në vitet e fundit kemi marrë një rol më aktiv duke kredituar bujqësinë dhe sektorë të lidhur me të, investimin në fushën e eficientës së energjisë dhe shumë shërbime të lidhura me sektorin e turizmit.

